

Vendi: Zllakuqan, Klinë

Data:03.11.2024

PROCESVERBAL

Zgjedhjet e Këshillit Lokal në Zllakuqan

Fillimi takimi të këshillit lokal: ora 16:07 Përfundimi i takimit: ora 19.10

Përfaqsuesit e fshtarave kanë organizuar takimin me bashkëfshatar në objektin e shkolles fillore në Zllakuqan, në këtë takim ishin prezent 6 antarë të komisionit.

Në sallen e votimit ishin prezent 5 antaret e komisionit, Kryetari I komisionit z.Binak Sylaj filloj me prezantimin e qëllimit për zgjedhjet e Këshillit lokal, duke përmendur dhe theksuar se do të jetë një kryesi me antarë të saj që do të përfaqsojn nevojat e komunitetit të fshatrave si: Zllakuqan, Berkovë, Radulloc, Pataqan, Krushevë e vogël, Ranoc, Leskoc dhe Dranashiq.

Pas këtij prezantimi detajor sipas udhëzimit administrativ nga kryetari I komisionit, të gjithë përfaqsuesit e qytetarëve të fshatrave që ishin prezent në atë klase votimi ishin dakord që votimi të jetë i fshehtë dhe secili do të jep voten e tij të lirë.

Z.Binak Sylaj sipas udhëzimit administrative kërkoi nga fshataret prezent që të propozojn një përfaqsues të fshatit që të jetë pjesë e komisionit, një nga qytetaret propozoi znj.Orselina Lazraj, ajo mori miratimin e qytetareve prezent dhe iu bashkua komisionit, edhe pse ajo shprehu personalisht që nuk kishte ndonjë njohuri rreth këtij procesi por pranoi të jetë pjesë e komisionit.

Gjithashtu, ne si Komision propozuam që votimi të përfundoj në ora 18:00, pasi që është kohë e mjaftueshme të votohet dhe masa prezente ishte dakord aë dera e shkolles të mbyllt në ora 18:00, gjithashtu vendosen që Këshilli Lokal të jetë prej 9 antarëve.

Fshataret filluan me propozimet e tyre për kryetar të Këshillit Lokal në Zllakuqan:

Filluan me propozime:

1. Bete Gojani
2. Ilir Kolaj
3. Simon Perlaskaj

Me ndihmen e Drejtoreshes së shkolles, e cila lehtësoi procesin tonë dhe fotokopjoj listë me emra të kandidateve që të mos humbim kohe. Filloi votimi pas disa minutash por ndërkoqë u krijuar një tollovi, mbrenda klases së vendvotimit kishte shumë njërzë, që për antaret e komisionit ishte pak e veshtirë për të punuar dhe ishte vertet një mosdurim nga ana e qytetarëve për të votuar.

Gjatë procesit të votimit, u krijuar një mosmarrveshje mbrenda komisionit dhe si shkaktare e kësaj ishte përfaquesja e fshatit që ishtë pjesë e komisionit që filloi të keqpërdor rolin e saj në komision (*ngritje të zërit, britma, drejtim të votuseve për një kandidat të caktuar*), kjo dukuri ngriti tension mbrenda antareve të komisionit, dhe antari Lugj Ademi dhe Arta Pantina herkuar që ajo të largohet nga kutia votuese menjëherë. Pas pak sekondash komisioni mori vete dhe u organizuan që të vazhdojn procesin.

Kohë pas kohe, zyrtaret policor ishin tërë kohen tek dera e Klases duke mbajtur rendin në koridor pasi që shihej një fluks i madh i votueseve, dhe gjithashtu masa bënte presion që antaret e komisionit të punonin më shpejtë.... Gjë që ishte e pamundur nga ana jonë.

Në ora 18:00 koridori shkolles ishte me plotë qytetar që pritnin për të votuar dhe nuk ishin dakord tani që të mbyllej klasa e vendvotimit në atë orë, prandaj në ora 18:21 me kërkesë të antareve të komisionit mbyllem deren e shkolles (Unë personalisht mbylla deren), edhe pse antarja Arta Pantina disa herë e potencoi se ashtu jemi dakorduar në fillim të takimit që në kohë të caktuar të mbyllët vendovotimi, Por prap edhe pas kësaj ore!... Edhe pse kemi mbyllur deren dikush e ka hapur prap dhe njëzit vazhdonin të vinin për të votuar deri në 18.40 deri kur nuk kishte më votues.

Lista e nënshkrimeve të votuesve ishte 388, Filluam numrimin e votave në ora 18:45,

Vota të pavlefshme: 2 votë

1. Kryetar: Simon Perlaskaj (166 vota)
2. NënKryetar: Bete Gojani (114 vota)
3. Sekretar: Ilir Kolaj (106 vota)

Propozuan me vota të hapura edhe antaret e kryesisë së Këshillit lokal:

4. Mark Lleshaj-Zllakuqan
5. Lorenc Kqiraj- Leskoc
6. Gjon Miredita- Ranoc
7. Albert Dedaj- Krushevë e vogël
8. Loreta Tanushi-Berkovë
9. Zef Hiqimi-Zllakuqan

Zgjedhjet e këshillit lokal në Zllakuqan u zhvilluan me sukses pa asnjë incident, dhe takimi përfundoi në ora 19.10



Komisioni prezent:

Kryetar i komisionit: Binak Sylaj

Asamblete: Arta Pantina

Asmblist: Luigj Ademi

Asmblist: Ndrec Zefaj

Asamblist: Zafer Gshiu

OJQ: Vitore Zefi

Përfaqësuesi i fshatrave: Orselina Lazraj Orselina Lazri

Proces mbajtës: Vitore Zefi

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Vitore Zefi".